



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2651/1 prot

Datë 26.08.2026

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-94853-07-29-2026, me objekt: “*Blerje makina teknologjike, (grirese mbetje te gjelberta)*”, me fond limit 5,750,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.08.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Ankimues: Operatori ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK me NIPT (M51901012F) dhe adresë: Magazine 1 katëshe, mbas kështjellës Konti, Zona Kadastrale 3712, Nr. pasurie 18/54, Vaqarr, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq, me adresë: Bulevardi “Rinia”, Maliq

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/7198, datë 25.08.2026 dhe me nr. protokolli 2651/2026 datë 25.08.2026 e operatorit ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-94853-07-29-2026, me objekt: “*Blerje makina teknologjike, (grirese mbetje te gjelberta)*”, me fond limit 5,750,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.08.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Nova Motor Solutions” SHPK kundërshton me anë të ankesës së tij. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë kontrollit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik konstatoi se Operatori Ekonomik “Nova Motor Solutions” shpk është themeluar dhe regjistruar pranë organeve kompetente gjatë vitit 2025. Në këtë rast kërkesa konsiderohet e papërmbushur pasi nuk janë paraqitur dy bilance të njëpasnjëshme në të cilët nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin Nr.16/2024, neni 92, Shqyrtimi i ofertave , pika 3 [...një ofertë është e vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e kërkuara në DST....] , KVO ,duke qënë se operatori ekonomik nuk plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST ,nuk pranon ofertën e paraqitur prej tij.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 26.08.2026.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar
Donika Daci**

**Anëtar
Nertil Kanina**

**Nënkryetar
Gjergj Mersini**